

**LIGJ**  
**Nr.9202, datë 4.3.2004**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MAKIMPORT SHKUP PËR RISKEDULIMIN E BORXHIT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**Neni 1**

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Makimport Shkup për riskedulimin e borxhit”.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4185, datë 29.3.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

**MARRËVESHJE**  
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE**  
**MAKIMPORT SHKUP LIDHUR ME RISKEDULIMIN E BORXHIT**

Marrëveshje e datës 17 dhjetor 2003, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (Qeveria), përfaqësuar nga Ministri i Financave dhe Makimport Shkup.

**Neni 1**

Subjekti i kësaj Marrëveshjeje është riskedulimi i detyrimeve të Agroeksportit Tiranë (Agroeksport) kundrejt Makimportit Shkup (Makimport), që rrjedhin nga transaksionet tregtare të realizuara, mbështetur në kontratën nr.1/9/MA/90, datë 2.9.1990 dhe kontratën nr.209/8/90, datë 21.8.1990 ndërmjet Agroeksportit dhe Makimportit, të mbetura të papaguara deri më 31.8.2003.

Shuma e detyrimit, mbështetur në vendimin e Arbitrazhit të Tregtisë së Jashtme pranë Dhomës së Tregtisë, arrin në 1 148 307.03 USD dhe 1 285 706 lekë.

**Neni 2**

Makimport heq dorë nga kërkesa e shumës prej 813 413 .45 USD, që përfaqëson interes-vonesat të llogaritura deri në datën 31.8.2003.

Qeveria angazhohet t'i paguajë Makimportit detyrimin prej 1 285 706 lekësh me një kësht të vetëm menjëherë me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, ndërsa detyrimi prej 1 148 307.03 USD do të paguhet me katër kështe të barabarta, të njëpasnjëshme, gjashtëmujore, duke filluar nga 15.1.2004 deri më 15.7.2005.

Pagesat në USD do të kryhen në llogarinë e Makimport Shkup, Nr. 1.0.19460 Montebre, pranë bankës PKB PRIVATBANK A.G., Lugano, Switzerland, ndërsa pagesa e detyrimit në lekë do të kryhet në Bankën Amerikane të Shqipërisë, në numrin e llogarisë që do të njoftohet me shkrim nga Makimporti brenda tridhjetë ditëve nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje.

### Neni 3

Mbi detyrimin në USD do të paguhet interesa në masën 1%, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Përfshijë pagesën e parë të interesit, pagesa e interesit do të bëhet në këtë gjashtëmujore. Interesi do të paguhet në të njëjtat data me pagesën e principalit dhe do të llogaritet mbi bazën e vitit prej 365 ditësh dhe për numrin faktik të ditëve të kaluara.

### Neni 4

Në rast se Qeveria nuk do të përmbushë në afat detyrimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje, atëherë, duke filluar nga data kur duhet kryer pagesa deri në datën e kryerjes së saj, Qeveria do të paguajë interes-vonesat në masën Libor gjashtëmujor +1%.

### Neni 5

Për çdo problem, palët do të komunikojnë me njëra-tjetrën me shkrim në gjuhën shqipe, në adresat e mëposhtme:

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së  
Shqipërisë, Ministrit të Financave  
Ministria e Financave  
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Nr.1  
Tiranë, Shqipëri  
Tel: ++ 355 4 228405  
Fax: ++ 355 4 228494

Për Makimport Shkup  
Z.Nushi Isein Kerliu  
Makimport, Shkup  
Rr. "H.T.Karposh", Nr.24  
Tel: ++ 389 2 2600 408  
Fax: ++ 389 2 2600 413  
Cel: ++ 389 70 231787

### Neni 6

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit përfundimtar me të cilën të dyja palët do të njoftojnë zyrtarisht përfundimin e procedurave të brendshme të parashikuara nga legjislacioni përkatës.

Bërë më 17.12.2003, në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Për  
Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë  
Ministër i Financave  
Kastriot Islami

Për  
Makimport Shkup  
Përfaqësues i autorizuar  
Kerliu Isein Nushi